

PROCESVERBAL 4/2022

I mbajtur me rastin e takimit të 4 (katërt) për vitin 2022 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 26.04.2022 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153;
3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për emërimin e komisionit për ndarjen e mirënjohjeve për “13 Qershorin”;
4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin vendimit 01-Nr-016-12176;
6. Të ndryshme;

Takimin e hapi Kryesuesi i komitetit për Komunitete z.Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.
Kryesuesi - a pajtoheni me rendin e ditës?

Aprovohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - a pajtoheni me procesverbalin?

Aprovohet.

Pika2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153;

Avni Bytyqi - përshëndet të pranishmit.Para dy muajsh është themelua komisioni për çështjen e pronës, për Bashkim Hoxhën dhe Sami Elahanin.Mirëpo njëri prej anëtarëve ka dhënë dorëheqje,dhe ajo është Festë Kabashi.Andaj ne e kemi obligim që ta bëjmë plotësim-ndryshimin e këtij vendimi në Kuvendin e Komunës.

Kryesuesi - a pajtoheni ?

Aprovohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-12153;

Avni Bytyqi - e dini që në vitin 2003 me vendim të Kuvendit “Emblema e Artë”,”Skënderbeu”,dhe mirënjohjes së “13 Qershorit”,është themelua për çdo mandat nga një komision në përbërje prej 7 anëtarëve. Dhe ,me që tani është mandat i ri i këtij Kuvendi,ne kemi obligim ligjor që ta themelojmë një komision prej 7 anëtarëve me qëllim që për 4 vitet e ardhshme ti shqyrtojmë kërkesat për ndarjen këtyre mirënjohjeve.

Kryesuesi - a pajtoheni?

Aprovohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale;

Avni Bytyqi - ka të bëjë me komisionin e zgjedhjeve të këshillave lokale. Është një udhëzim administrativë i ministrisë së pushtetit lokal që ka dal në fund të 2019-tës, dhe na obligon që ta themelojmë komisionin për zgjedhjen e këshillave të fshatrave.

Kryesuesi - a pajtoheni?

Aprovohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin vendimit 01-Nr-016-12176;

Avni Bytyqi - prej dy muajsh kemi marrë vendim për kompensimin e shujtës për punëtorët e administratës. Mirëpo ministria e financave e ka kthyer në rishqyrtim, si pasojë që nuk lejohet kompenzimi i shujtës nga kategoria mallra dhe shërbime, dhe ne e kemi obligim ta shfuqizojmë.

Kryesuesi - a pajtoheni?

Aprovohet

Pika 6. Të ndryshme;

Nazim Shabanaj - përshëndet të pranishmit. Kjo është mbledhja e tretë që unë kërkoj zgjidhje për ndriçim, dhe ende ska zgjidhje.

Kryesuesi - unë kam bisedu me Enverin, dhe çështja, se pse ska ndriçim është çështja e trafos, sepse ormani ekzistues nuk mundet me furnizim mjaftueshëm. Në moment që fola, ai më tha që sot kanë me dal në teren dhe kanë me montu ormanin e ri.

Nazim Shabanaj - një orman është vendos gati dy muaj.

Avni Bytyqi - ka mundësi që Komuna nuk ka ende kontratë me ndonjë operatorë për me rregullu qështjesn e ndriçimit, dhe në moment që ka kontratë do të rregullohet.

Nazim Shabanaj - te ura ka me u ndreq ni mur, sepse është rrezik. Është dhënë buxheti, por ende është ashtu.

Kryesuesi - ju duhet me bo kërkesë, që ura mu nëdrru krejt.

Nazim Shabanaj - Kryetari na ka thënë që do të ndërtojnë lodrat për fëmijë. Krejt fshatrat i kanë, veq fshati Gelancë nuk i ka. Tjetra, kanalizimi i krejt katunit pom doket ka me ardh te ura.

Kryesuesi - ju duhet me bo bashkarisht me gjithë banorët ni kërkesë.

Kryesuesi - te MAPL, është nda buxhet nëpër Komuna dhe është specifik për Komunitetet. Sa i përket këtij buxhetit, ne mundemi me marrë kërkesa nëpë lagje. P.sh. është rruga në Leshan që s'është ndërto, kanalizimi në Gelancë dhe ura e rrugica të ndryshme. Pra ne fillimisht duhet të kemi përgjigje nga Komuna se sa është buxheti prej MAPL-së për komunitete dhe mbas kësaj ne duhet mu adresu me kërkesa.

Avni Bytyqi - atëherë le të jetë, që të shohim sa ka buxhet dhe pastaj me kërku nga Kryetari që me i rregullu këto infrastruktura.

Takimi përfundoi: **09:15**